Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0606

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahimi, Kimete Gashi Brajshori dhe Isa Hasani duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.T. „Fer-Petroll, kundër Vendimin për dhanje të konrates nga - KOMUNA E PEJES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa II LOT 7 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa III LOT 8 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnovë – Gjorë pjesa II LOT 9 Asfaltimi i anekseve të rrugëve në fshatrat e Rugovës(Shtupeq i madh dhe Shtupeq i vogel)me numër të prokurimit 635-26-3347-5-1-1, me 28.10.2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërishte e bazuar ankesa e OE N.T. „Fer-Petroll me nr. 2026/0606 , e datës 17/08/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit për LOT 8 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnovë – Gjorë, Kodi 54660 , me nr. të prokurimit: "635-26-3347-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES.

2. Anulohet në tërsi, në munges të ofertave të përgjegjshme aktiviteti i prokurimit sipas ankesës për LOT 8 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnovë – Gjorë, Kodi 54660 , me nr. të prokurimit: "635-26-3347-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES, me numër të prokurimit 635-26-3347-5-1-1.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK

për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik N.T. „Fer-Petroll.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.05.2026 KOMUNA E PEJES., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës LOT 1 Ndërtimi i rrugës Poçest – Dobërdol LOT 2 Asfaltimi i rrugës Zagerëm – Lubeniq LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hidro Drin – Maja e Zezë LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dushkajë LOT 5 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karagaq, Jarinë, Xh. Kada, Spitalit, Kristal, 7 Shtatori pjesa I LOT 6 Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotuareve në qendër të qytetit, lagjet Pohovc, Karaga me numër të prokurimit 635-26-3347-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur; lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës totale : 797,368,70 euro.

Me 22.07.2026 KOMUNA E PEJES duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë Grupi i operatorëve ekonomk: DOREARTI SH.P.K & LANI- Al SH.P.K ".

Me 05.08.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 06.08.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 17.08.2026, OE N.T. „Fer-Petroll, ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0606, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhenie te kontrates.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T. „Fer-Petroll, janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues, gjatë vlerësimit të Dosjeve të Tenderit me titull: "Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës - LOT 8 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnovë – Gjorë, pjesa II", me nr. të Prokurimit: 635-26-3347-5-1-1 dhe numër të brendshëm: 635-26-033-511, ka bërë shkelje të rënda të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës.

Më dt. 22.07.2026, në zyrën e prokurimit, në Autoritetin Kontraktues, Komuna e Pejës, ne kemi kërkuar qasje të pakushtëzuar, në bazë të Nenit 10, pika 3 dhe pika 5, te operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, Raportin e Vlerësimit, Vërtetimin e ATK-së, Certifikatën e Gjykatës Ekonomike dhe Sigurimin e Tenderit.

Pas qasjes në dokumente të Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për dhënie të kontratës, Konsorciumit "Dorearti" Sh.p.k. & "Lani-AL" Sh.p.k., kemi vërejtur shumë shkelje të LPP-së dhe Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, të bëra nga Autoriteti Kontraktues, Komuna e Pejës, konkretisht Zyra e Prokurimit.

Ne kemi konstatuar se grupi i Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për dhënie të kontratës, "Dorearti" Sh.p.k. & "Lani-AL" Sh.p.k., nuk janë të përgjegjshëm, sepse:

"Lani-AL" Sh.p.k. nuk e ka të mbushur mirë Formularin e Tenderit, konkretisht Deklaratën Nën Betim, që në bazë të UDHËZUESIT Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik është kusht administrativ për Autoritetin Kontraktues ta refuzojë tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshme. Deklarata në fjalë nuk e ka datën e hapjes së tenderit.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për dhënie të kontratës, "Dorearti" Sh.p.k. & "Lani-AL" Sh.p.k., nuk kanë arritur të dëshmojnë se e kanë përmbushur kriterin tek Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2, ku kërkesa nga AK ka qenë: "Për (LOT – 8) Operatori ekonomik duhet t'i ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit financiare, duhet të jetë jo më pak se 900.000.00 Euro, qarkullimi vjetor për 3 vitet e fundit".

Dëshmia, për LOT 8 – Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo në vendin e themelimit, apo kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur. Grupi i Operatorëve Ekonomikë nuk i ka paraqitur këto dëshmi, të cilat e dëshmojnë që e plotëson këtë kriter. Nëse një kompani nuk e plotëson kriterin e qarkullimit vjetor të kërkuar në Dosjen e Tenderit, atëherë, në parim, nuk duhet të kualifikohet dhe nuk duhet të shpallet fituese. Autoriteti Kontraktues është i detyruar t'i zbatojë kriteret e kualifikimit ashtu siç janë përcaktuar në njoftimin dhe Dosjen e Tenderit.

Gjithashtu, ligji parashikon se Autoriteti Kontraktues duhet të diskualifikojë operatorin ekonomik që nuk paraqet dëshmi të mjaftueshme se i plotëson kërkesat minimale financiare të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për dhënie të kontratës, "Dorearti" Sh.p.k. & "Lani-AL" Sh.p.k., nuk kanë arritur të dëshmojnë se e kanë përmbushur kriterin tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, konkretisht tek kontratat e ngjashme, ku kërkesa nga AK ka qenë: "Për (LOT-8) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të natyrës së ngjashme në vlerë prej 700.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit, Udhëheqësi duhet t'i ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3 vitet e shkuara. Për (LOT-8) Dëshmia: Një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar ANEKSIN 6 të Dosjes së Tenderit, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës t'i bashkëngjiten referencat për kryerje të punëve."

Grupi i Operatorëve Ekonomikë “Dorearti” Sh.p.k. & “Lani-AL” Sh.p.k., i rekomanduar për dhënie të kontratës, nuk i plotëson as kriteret për përvojë të ngjashme (referenca dhe kontrata të ngjashme). Dokumentet e paraqitura nuk dëshmojnë realizimin e kontratave që përmbushin kërkesat minimale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit për natyrën, vlerën ose periudhën e kërkuar. Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar në mënyrë të barabartë kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e prokurimit, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik që kërkojnë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe vlerësim vetëm mbi bazën e kritereve të shpallura. Mosrespektimi i kritereve të kualifikimit cenon parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së ndershme, duke e bërë vendimin për dhënie të kontratës të pabazuar në ligj dhe në dokumentet e tenderit.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e plotëson kriterin e stafit profesional, ashtu siç është kërkuar në Formularin e të Dhënave të Tenderit (FDT). Dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon se grupi i operatorëve ekonomikë disponon stafin minimal të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Përkundër këtij fakti, Autoriteti Kontraktues e ka kualifikuar dhe shpallur fitues grupin e operatorëve ekonomikë “Dorearti” Sh.p.k. & “Lani-AL” Sh.p.k., duke mos zbatuar kriteret e kualifikimit të përcaktuara në FDT dhe duke vepruar në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe ligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik. Për këto arsye, kërkojmë që vendimi për dhënie të kontratës të anulohet, grupi i operatorëve ekonomikë të diskualifikohet për mosplotësim të kriterit të stafit profesional dhe të bëhet rivlerësimi i ofertave në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

Inxh. z. Nysret Kastrati i mungojnë referencat, dëshmia e punës, siç është kërkuar në FDT. Nuk ka paraqitur as kontrata të mëhershme që dëshmojnë një gjë të tillë, e as Trust pensional, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Inxh. z. Leotrim Besim Kolloni, njëjtë, i mungojnë referencat, dëshmia e punës, siç është kërkuar në FDT. Nuk ka paraqitur as kontrata të mëhershme që dëshmojnë një gjë të tillë, e as Trust pensional, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Inxh. z. Fatlind Muhamet Sadikaj, prapë njëjtë, i mungojnë referencat, dëshmia e punës, siç është kërkuar në FDT. Nuk ka paraqitur as kontrata të mëhershme që dëshmojnë një gjë të tillë, e as Trust pensional, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Inxh. znj. Ariana Lajqi, Inxhiniere e Infrastrukturës Rrugore, i mungon Certifikata e NVM-së e kërkuar në FDT.

Baxhelore e Ambientit, znj. Fatbardha Ferat Ferataj, nuk e ka kualifikimin Inxhinier, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, mirëpo Bachelor. Gjithashtu, certifikatën e NVM-së e ka të skaduar më dt. 27.10.2025. Kërkesa në FDT - 6. Inxhinier i Ambientit, i certifikuar si NVM, me minimum 5 vite përvojë pune – pas diplomimit.

Duke i parë të gjitha këto dëshmi, Komisioni i Vlerësimit dhe Shefi i Prokurimit kanë vepruar në kundërshtim me kërkesat e Formularit të të Dhënave të Tenderit (FDT), duke rekomanduar për dhënie të kontratës një grup operatorësh ekonomikë që nuk e plotëson kriterin e detyrueshëm për stafin profesional. Dokumentacioni i ofertës dëshmon qartë se grupi i operatorëve ekonomikë nuk disponon stafin minimal të kërkuar sipas FDT-së. Përkundër kësaj, Komisioni i Vlerësimit e ka kualifikuar ofertën si të përgjegjshme dhe Shefi i Prokurimit e ka proceduar vendimin për

dhënie të kontratës, duke anashkaluar kriteret e detyrueshme të kualifikimit. Një veprim i tillë përbën shkelje serioze të procedurës së prokurimit, cenon integritetin e procesit të vlerësimit dhe bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe ligjshmërisë. Pranimi dhe rekomandimi i një grupi të operatorëve ekonomikë që nuk i plotëson kriteret e detyrueshme nuk mund të konsiderohet vlerësim i ligjshëm dhe objektiv. Për këto arsye, kërkojmë anulimin e menjëhershëm të vendimit për dhënie të kontratës, rivlerësimin e ofertave në përputhje me dokumentet e tenderit dhe shqyrtimin e përgjegjësisë administrative të Komisionit të Vlerësimit dhe Shefit të Prokurimit për moszbatimin e kritereve të detyrueshme të kualifikimit.

Marrëveshja për furnizim me beton e paraqitur nga Konsorciumi "Dorearti" Sh.p.k. & "Lani-AL" Sh.p.k. është marrëveshje të cilës i mungon Leja Mjedisore e lëshuar nga MMPH, e cila ka qenë kriter në Dosjen e Tenderit dhe nuk kanë arritur ta paraqesin.

Marrëveshja për furnizim me asfalt nga Kompania KAG Asfalt nuk është nënshkruar në prezencën e noterit, siç është kërkuar, dhe nuk është e NOTERIZUAR.

Marrëveshja për furnizim me zhavorr me kompaninë GURBARDHI nuk është nënshkruar në prezencën e noterit, siç është kërkuar, dhe nuk është e NOTERIZUAR. Dhe licenca e paraqitur nuk është Gurthyes, mirëpo është Shkëmb i Fortë me nr. të regjistrit: 2239.

Grupi i operatorëve ekonomikë nuk e ka përmbushur kërkesën e detyrueshme të përcaktuar në Formularin e të Dhënave të Tenderit (FDT), pasi marrëveshjet e furnizimit të paraqitura nuk janë të noterizuara, edhe pse një kërkesë e tillë është përcaktuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues në dokumentet e tenderit. Pranimi dhe vlerësimi si të përgjegjshme i një oferte që nuk përmbush kërkesat e detyrueshme të FDT-së është në kundërshtim me nenin 51 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP), i cili përcakton kërkesat për përshtatshmërinë dhe kriteret e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, si dhe me nenin 59 të LPP-së, që obligon Autoritetin Kontraktues të shqyrtojë, vlerësojë dhe krahasojë tenderët në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Mosrespektimi i kërkesave të detyrueshme të FDT-së cenon gjithashtu nenin 7 të LPP-së (Barazia në trajtim / mosdiskriminimi dhe transparenca), pasi operatorët ekonomikë duhet të vlerësohen sipas të njëjtave kushte dhe kritere të shpallura në procedurën e prokurimit. Për këto arsye, oferta e grupit të operatorëve ekonomikë nuk ka bazë të konsiderohet e përgjegjshme dhe duhet të trajtohet në përputhje me kërkesat e FDT-së dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Grupi i operatorëve ekonomikë nuk ka përmbushur kërkesën e detyrueshme të përcaktuar në Formularin e të Dhënave të Tenderit (FDT) lidhur me makineritë dhe pajisjet e kërkuara për realizimin e kontratës. Dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon se operatori ekonomik posedon ose ka në dispozicion makineritë dhe pajisjet minimale të kërkuara sipas kushteve të tenderit. Përkundër kësaj, oferta është konsideruar e përgjegjshme, edhe pse mungojnë elementet thelbësore të kapaciteteve teknike dhe profesionale të kërkuara.

Grupit të Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për dhënie të kontratës i mungon:

1. Rimorkio për bartjen e makinerive, pesha bartëse min. 36 t. Grupi i rekomanduar ka paraqitur një rimorkio me peshë bartëse 17.200 kg ose 17.2 t.

Ky veprim është në kundërshtim me nenin 51 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, lidhur me kriteret e përzgjedhjes dhe dëshminë e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, si dhe me nenin 59 të LPP-së, i cili obligon Autoritetin Kontraktues që shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ta bëjë vetëm në bazë të kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në dosjen e tenderit. Mosplotësimi i kërkesave për makineri dhe pajisje përbën mungesë të kapaciteteve teknike të kërkuara dhe cenon parimet e përcaktuara në nenin 7 të LPP-së për trajtim të barabartë, transparencë dhe konkurrencë të ndershme.

Të gjitha këto prova dhe dëshmi tregojnë qartë se si AK, Komuna e Pejës, bën shkelje të Ligjit dhe dispozitave të LPP-së dhe Prokurimit Publik, e të gjitha do t'i gjeni të bashkëngjitura kësaj kërkese për Rishqyrtim.

Autoriteti Kontraktues, me rekomandim për dhënie të kontratës Konsorciumit "Dorearti" Sh.p.k. & "Lani-AL" Sh.p.k., e ka shkelur rëndë Nenin 1, Nenin 6 dhe Nenin 7.

Konsorciumi N.T. "Fer – Petroll" & "V-SHEHU" SH.P.K. është i vetmi i përgjegjshëm në këtë AP dhe me i lirë se grupi i operatorëve ekonomikë të rekomanduar për dhënie të kontratës në shumën prej 101,068.63 €. Këtu shihet qartë se AK dëmton e shkatërron taksat e qytetarëve dhe Buxhetin e Republikës së Kosovës, duke anuar plotësisht nga kompanitë e shpallura fituese.

Më dt. 22.07.2026, Autoriteti Kontraktues, Komuna e Pejës, konsorciumin tonë e ka eliminuar nga gara pa të drejtë dhe pa fakte. Autoritet i nderuar, ju keni shkelur vetë kriteret e vendosura në Dosjen e Tenderit, duke rekomanduar një grup të OE të papërgjegjshëm dhe më të shtrenjtë në vlerë prej 101,068.63 €.

ARSYETIMI I AK:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga grupi i operatorëve ekonomikë N.T. "Fer-Petroll" dhe "V-SHEHU" SH.P.K., janë konstatuar këto mospërputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit (DT) dhe Njoftimit për Kontratë (NJK):

Për (LOT – 8), Kërkesa 2 – Stafi Profesional.

Pretendimi 1: Bachelor, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit.

"Sipas Kërkesës së AK është kërkuar që, lidhur me projektin, të paraqitet Kontratë ose Parakontratë në emër të projektit. OE ka paraqitur një MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM PROFESIONAL e jo një Kontratë ose Parakontratë, ashtu siç është kërkuar në DT dhe Njoftimit për Kontratë. OE gjithashtu ka prezantuar këtë marrëveshje, në të cilën mungojnë elemente bazë të një kontrate, siç janë: Orari i punës brenda të cilit është i angazhuar Gjeodeti; gjithashtu nuk është paraqitur vlera e pagesës, e cila është e domosdoshme sipas ligjit të pagesës dhe kontratës. Gjithashtu, marrëveshja e paraqitur figuron me dt. 03.07.2027, që nënkupton se marrëveshja si e tillë fillon nga ky vit, pra 2027, dhe nuk mund të jetë aktive deri në këtë vit. Në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin mbi Kontratë është kërkuar që Bachelor i Gjeodezisë të paraqesë përvojën e punës me Referencë. OE ofertues ka dështuar të paraqesë Referencë pune mbi përvojën e punës sipas kërkesës së AK në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin e Kontratës, duke mos paraqitur 3 vite përvojë pune sipas kushteve të DT dhe NJK."

SQARIM 1:

Lidhur me kërkesën për stafin profesional, sqarojmë se ne, grupi i Konsorciumit, e kemi paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit me inxhinierët përkatës, e cila në përmbajtje të saj dëshmon qartë disponueshmërinë, vullnetin dhe angazhimin paraprak të stafit profesional për realizimin e kontratës.

Edhe pse në Formularin e të Dhënave të Tenderit është kërkuar kontratë pune ose parakontratë, dokumenti i dorëzuar nga konsorciumi ynë duhet të trajtohet si dokument ekuivalent, pasi përmbush të njëjtin qëllim të kërkesës së Autoritetit Kontraktues – dëshmimin se operatori ekonomik ka siguruar dhe ka në dispozicion stafin profesional të nevojshëm për zbatimin e kontratës.

Marrëveshja e bashkëpunimit nuk është thjesht deklaratë vullneti, por paraqet një zotim të shkruar ndërmjet palëve për bashkëpunim dhe angazhim të stafit të caktuar në projektin e caktuar, duke garantuar që, në rast të shpalljes fitues, operatori ekonomik do të formalizojë marrëdhënien kontraktuale sipas kërkesave ligjore dhe kontraktuale.

Qëllimi i kërkesës për kontratë pune ose parakontratë nuk është që operatori ekonomik të krijojë marrëdhënie të plota pune para përfundimit të procedurës së prokurimit, por të dëshmojë se ka kapacitetet njerëzore dhe stafin në dispozicion për realizimin e kontratës.

Ky qëllim është arritur përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të paraqitura.

Prandaj, mospranimi i kësaj dëshmie vetëm për shkak të formës së dokumentit, përkundër faktit se ajo dëshmon të njëjtin element – disponueshmërinë e stafit profesional – do të ishte një qasje tepër formale dhe jo proporcionale. Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të konsiderohet si dokument ekuivalent për përmbushjen e kërkesës së FDT-së. Tek data ka ndodhur një gabim teknik, ku me kërkesë për sqarim gjithçka ishte rregulluar. Gjithashtu, edhe tek referencat keni pasur mundësi t'i kërkoni informacione shtesë që t'ju dërgojmë, mirëpo, për shkak të kohës së shkurtër të publikimit të cilin e keni bërë, gjatë skanimit të dokumentacionit nuk janë kapur referencat. Megjithatë, sipas kërkesave të FDT-së, Operatorët Ekonomikë kanë mundur t'i bashkëngjitin edhe dëshminë e Trustit, ku inxhinieri ynë e ka të bashkëngjitur Trustin Pensional.

Pretendimi 2: 6. Inxhinieri i Ambientit, i certifikuar si NVM, me minimum 5 vite përvojë pune – pas diplomimit.

"Sipas Kërkesës së AK është kërkuar që, lidhur me projektin, të paraqitet Kontratë ose Parakontratë në emër të projektit. OE ka paraqitur një MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM PROFESIONAL e jo një Kontratë ose Parakontratë, ashtu siç është kërkuar në DT dhe Njoftimin për Kontratë. OE gjithashtu ka prezantuar këtë marrëveshje, në të cilën mungojnë elemente bazë të një kontrate, siç janë: Orari i punës brenda të cilit është i angazhuar Ambientisti, gjithashtu nuk është paraqitur vlera e pagesës, e cila është e domosdoshme sipas ligjit të pagesës dhe kontratës. Gjithashtu, marrëveshja e paraqitur figuron me dt. 03.07.2027, që nënkupton se marrëveshja si e tillë fillon nga ky vit, pra 2027, dhe nuk mund të jetë aktive deri në këtë vit.

CV e panënshkruar. Inxhinieri Ibush Luzha nuk e ka të nënshkruar CV-në sipas kërkesës së AK. Inxhinieri i Ambientit në CV-në e tij ka deklaruar se është në marrëdhënie pune në UBT – Universiteti për Biznes dhe Teknologji (Instituti i Arsimit të Lartë), Profesor Asistent – Fakulteti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologji dhe Fakulteti për Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari dhe Infrastrukturë), në kompaninë e tij Golden Consulting Center Sh.p.k., Prishtinë, si dhe

Ekspert Gjyqësor për Mjedis.

Duke pasur parasysh kohën kaq të ngarkuar në të gjitha këto vende pune, atëherë nuk ka mundësi që brenda kësaj periudhe të angazhohet edhe në një kompani tjetër, duke pasur parasysh natyrën e projektit dhe kohën e punës për realizim."

SQARIM 2:

Tek kontratat dhe data i kemi sqaruar më lartë, ndërsa tek CV-ja e panënshkruar, në pretendimin se CV-ja e inxhinierit në fjalë nuk është e nënshkruar, theksojmë se kjo mangësi është thjesht formale dhe nuk ndikon në përmbajtjen, vërtetësinë apo besueshmërinë e dokumentacionit të paraqitur. Identiteti, kualifikimet profesionale, licenca dhe disponueshmëria e inxhinierit janë dëshmuar përmes dokumenteve të tjera të dorëzuara në ofertë. Për rrjedhojë, mungesa e nënshkrimit në CV nuk e ndryshon faktin se ne, grupi i konsorciumit, e kemi në dispozicion inxhinierin e kërkuar dhe i plotëson kapacitetet teknike për realizimin e kontratës.

Diskualifikimi për një mangësi që nuk ndikon në përmbajtjen e ofertës, në kapacitetin teknik të operatorit ekonomik apo në konkurrencën ndërmjet operatorëve do të ishte një masë joproporcionale dhe tepër formaliste, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe të konkurrencës efektive në procedurat e prokurimit publik. Legjislacioni i Republikës së Kosovës nuk ndalon që një person të jetë i angazhuar te më shumë se një punëdhënës.

Përkundrazi, Neni 7 i Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2016 për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale parashikon shprehimisht se: "I punësuari, nëse punon për një apo më tepër punëdhënës, cakton një punëdhënës kryesor."

Kjo dispozitë njeh qartë mundësinë që një person të punojë për më shumë se një punëdhënës, duke rregulluar vetëm përcaktimin e punëdhënësit kryesor për qëllime tatimore. Fakti që inxhinieri është i angazhuar edhe te një subjekt tjetër nuk nënkupton se ai nuk mund të angazhohet edhe nga konsorciumi ynë në këtë procedurë të prokurimit. Përderisa është paraqitur dokumentacioni që dëshmon disponueshmërinë dhe angazhimin e tij për realizimin e kontratës, nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore që ndalon një angazhim të tillë vetëm për shkak të ekzistimit të një marrëdhënieje tjetër pune.

Pretendimi 3: 2. Inxhinieri i Arkitekturës, Bachelor, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit.

"Sipas Kërkesës së AK është kërkuar që, lidhur me projektin, të paraqitet Kontratë ose Parakontratë në emër të projektit. OE ka paraqitur një MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM PROFESIONAL e jo një Kontratë ose Parakontratë, ashtu siç është kërkuar në DT dhe Njoftimin për Kontratë. OE gjithashtu ka prezantuar këtë marrëveshje, në të cilën mungojnë elemente bazë të një kontrate, siç janë: Orari i punës brenda të cilit është i angazhuar Inxhinieri i Arkitekturës, gjithashtu nuk është paraqitur vlera e pagesës, e cila është e domosdoshme sipas ligjit të pagesës dhe kontratës. Gjithashtu, marrëveshja e paraqitur figuron me dt. 03.07.2027, që nënkupton se marrëveshja si e tillë fillon nga ky vit, pra 2027, dhe nuk mund të jetë aktive deri në këtë vit."

SQARIM 3:

Tek kontratat dhe data i kemi sqaruar më lartë, është i njëjti pretendim nga Komisioni Vlerësues për të gjithë inxhinierët.

Pretendimi 4: 1. Inxhinier i Ndërtimtarisë/Konstruktiv, Bachelor, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit.

“Sipas Kërkesës së AK është kërkuar që, lidhur me projektin, të paraqitet Kontratë ose Parakontratë në emër të projektit. OE ka paraqitur një MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM PROFESIONAL e jo një Kontratë ose Parakontratë, ashtu siç është kërkuar në DT dhe Njoftimin për Kontratë. OE gjithashtu ka prezantuar këtë marrëveshje, në të cilën mungojnë elemente bazë të një kontrate, siç janë: Orari i punës brenda të cilit është i angazhuar Inxhinieri i Ndërtimtarisë/Konstruktiv, gjithashtu nuk është paraqitur vlera e pagesës, e cila është e domosdoshme sipas ligjit të pagesës dhe kontratës. Gjithashtu, marrëveshja e paraqitur figuron me dt. 03.07.2027, që nënkupton se marrëveshja si e tillë fillon nga ky vit, pra 2027, dhe nuk mund të jetë aktive deri në këtë vit. OE nuk e ka paraqitur përvojën e punës sipas kërkesës së AK, ku kërkohen 3 vite përvojë pune me dëshmi, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose Trusti. OE ka paraqitur inxhinierin e ndërtimtarisë përmes CV-së me përvojë pune, e cila nuk i përmbush kërkesat e AK sipas dosjes së tenderit. Si dëshmi sipas diplomës dhe CV-së citojmë: Studimet i mbaroi më 22 nëntor 2018, ndërsa CV-ja e ka të nënshkruar me 2019, që i bie gjithsej 13 muaj përvojë pune (shih nënshkrimin), gjë që e dëshmon se që nga viti 2019 inxhinieri në fjalë nuk ka paraqitur dëshmi të reja mbi përvojën e punës.”

SQARIM 4:

Tek kontratat dhe data i kemi sqaruar më lartë, është i njëjti pretendim nga Komisioni Vlerësues për të gjithë inxhinierët. Sipas nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues mund t’i kërkojë operatorit ekonomik sqarim me shkrim për çdo aspekt të ofertës, për të ndihmuar në shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, ku ka mundur të kërkojë informacion me referencat e inxhinierit. Gjatë skanimit nuk janë kapur referencat e inxhinierit në fjalë, mirëpo kësaj kërkese për Rishqyrtim do t’ia bashkëngjisim të gjithë dokumentacionin.

Pretendimi 5: 4. Master i Shkencave në Xehetari, i specializuar për shpim-plasje – pas diplomimit.

“Sipas Kërkesës së AK është kërkuar që, lidhur me projektin, të paraqitet Kontratë ose Parakontratë në emër të projektit. OE ka paraqitur një MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM PROFESIONAL e jo një Kontratë ose Parakontratë, ashtu siç është kërkuar në DT dhe Njoftimin për Kontratë. OE gjithashtu ka prezantuar këtë marrëveshje, në të cilën mungojnë elemente bazë të një kontrate, siç janë: Orari i punës brenda të cilit është i angazhuar Inxhinieri i Ndërtimtarisë/Konstruktiv, gjithashtu nuk është paraqitur vlera e pagesës, e cila është e domosdoshme sipas ligjit të pagesës dhe kontratës. Gjithashtu, marrëveshja e paraqitur figuron me dt. 03.07.2027, që nënkupton se marrëveshja si e tillë fillon nga ky vit, pra 2027, dhe nuk mund të jetë aktive deri në këtë vit. AK në dosjen e tenderit, si dëshmi të dokumenteve për inxhinierin, ka kërkuar që për secilin anëtar të stafit duhet të dorëzohen këto dëshmi: diploma universitare përkatëse (Bachelor ose Master); CV profesionale e nënshkruar; Certifikata/licenca profesionale përkatëse, aty ku kërkohet; Certifikata NVM, për pozitat ku kërkohet; dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrata në emër të projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti), sipas viteve të kërkuara. OE ka paraqitur inxhinierin e xehetarisë Xhevdet Kastrati, i cili nuk është i specializuar, specializim – shpim-plasje, dhe si i tillë nuk e plotëson kërkesën sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit mbi kontratë. Inxhinieri i xehetarisë, sipas dokumenteve të paraqitura në ofertë, dëshmon periudhën e diplomimit në vitin 2010, ndërsa që nga viti 2010 nuk ka paraqitur dëshmi mbi përvojën e punës sipas kërkesës.

Dëshminë e përvojës së punës ndërmjet periudhave e ka të paraqitur vetëm nga 2004–2007, ndërsa në referencat e tjera të paraqitura mungojnë periudhat e punës me të cilat dëshmon vitet e përvojës. AK në dosjen e tenderit, si dëshmi të dokumenteve për inxhinierin, ka kërkuar që për secilin anëtar të stafit duhet të dorëzohen këto dëshmi: diploma universitare përkatëse (Bachelor ose Master); CV profesionale e nënshkruar; Certifikata, licenca profesionale përkatëse, aty ku kërkohet; Certifikimi NVM, për pozitat ku kërkohet; dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontratë në emër të projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti), sipas viteve të kërkuara. OE ka paraqitur inxhinierin e Xehetarisë Xhevdet Kastrati, të cilit i mungon CV-ja e punës. Pra, nuk ka paraqitur fare CV."

SQARIM 5:

Tek kontratat dhe data i kemi sqaruar më lartë, është i njëjti pretendim nga Komisioni Vlerësues për të gjithë inxhinierët. Pretendimi i Autoritetit Kontraktues se z. Xhevdet Kastrati nuk posedon përvojën e mjaftueshme të punës dhe nuk është i specializuar në fushën e shpimeve është plotësisht i pabazuar, në kundërshtim me dokumentacionin e paraqitur dhe me faktet objektive.

Z. Xhevdet Kastrati është Master i Shkencave në fushën e Xehetarisë, me përvojë shumëvjeçare profesionale në këtë fushë. Për më tepër, ai është i certifikuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) që nga data 18.01.2007, çka dëshmon se posedon kualifikimet profesionale dhe kompetencat e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë në këtë fushë. Është veçanërisht kontradiktore që pikërisht Komuna e Pejës, e cila përmes organeve të saj gjatë viteve 2004–2007 ka bashkëpunuar me z. Xhevdet Kastrati dhe i ka lëshuar referenca për punën dhe angazhimin e tij profesional, tani pretendon se i njëjti nuk posedon përvojë të mjaftueshme apo nuk është i specializuar. Një qëndrim i tillë bie ndesh me dokumentacionin zyrtar të lëshuar nga vetë Autoriteti Kontraktues dhe ngre dyshime serioze mbi objektivitetin dhe konsistencën e vlerësimit të bërë në këtë procedurë.

Përvoja profesionale e z. Xhevdet Kastrati nuk mund të mohohet përmes konstatimeve të pabazuara, kur ajo dëshmohet me diplomë universitare, certifikim profesional nga KPMM, përvojë shumëvjeçare në terren dhe referenca të lëshuara edhe nga vetë Komuna e Pejës. Vlerësimi i bërë nga Autoriteti Kontraktues nuk mbështetet në fakte dhe prova, por bie ndesh me dokumentacionin zyrtar të dorëzuar në ofertë dhe me dokumentet që vetë ky autoritet ka lëshuar ndër vite, duke anuar komplet nga një konsorcium i rekomanduar për dhënie të kontratës, të cilët nuk i plotësojnë kërkesat minimale për të qenë fitues. Kërkojmë që ky konstatim i pabazuar të rishqyrtohet, pasi nuk ka asnjë bazë faktike apo ligjore për të vënë në dyshim kualifikimin profesional dhe përvojën e z. Xhevdet, të cilat janë të dokumentuara dhe të provuara me dokumente zyrtare.

Për më tepër, ky pretendim është edhe më i pabazuar, duke pasur parasysh se konsorciumi ynë nuk ka propozuar vetëm një ekspert për këtë pozitë, por ka paraqitur dy inxhinierë të diplomuar të xehetarisë, z. Xhevdet Kastratin dhe z. Islam Ahmetin, të cilët së bashku plotësojnë dhe tejkalojnë kërkesat e përcaktuara në Formularin e të Dhënave të Tenderit (FDT). Kjo dëshmon qartë se konsorciumi disponon kapacitet profesional të mjaftueshëm për realizimin e kontratës dhe se çdo konstatim për mungesë të ekspertizës është i pambështetur në faktet dhe dokumentet e dorëzuara. Këto fakte dhe argumente i keni të bashkëngjitura në Ofertën e dorëzuar nga konsorciumi ynë.

Pretendimi 6: 5. Master i Infrastrukturës Rrugore, i certifikuar si NVM, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit.

Sipas Kërkesës së AK është kërkuar që, lidhur me projektin, të paraqitet Kontratë ose Parakontratë në emër të projektit. OE ka paraqitur një MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM PROFESIONAL e jo një Kontratë ose Parakontratë, ashtu siç është kërkuar në DT dhe Njoftimin për Kontratë. OE gjithashtu ka prezantuar këtë marrëveshje, në të cilën mungojnë elemente bazë të një kontrate, siç janë: Orari i punës brenda të cilit është i angazhuar Inxhinieri i Ndërtimtarisë/Konstruktiv, gjithashtu nuk është paraqitur vlera e pagesës, e cila është e domosdoshme sipas ligjit të pagesës dhe kontratës. Gjithashtu, marrëveshja e paraqitur figuron me dt. 03.07.2027, që nënkupton se marrëveshja si e tillë fillon nga ky vit, pra 2027, dhe nuk mund të jetë aktive deri në këtë vit. AK në dosjen e tenderit, si dëshmi të dokumenteve për inxhinierin, ka kërkuar që për secilin anëtar të stafit duhet të dorëzohen këto dëshmi: diploma universitare përkatëse (Bachelor ose Master); CV profesionale e nënshkruar; Certifikata/licenca profesionale përkatëse, aty ku kërkohet; Certifikata NVM, për pozitat ku kërkohet; dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrata në emër të projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti), sipas viteve të kërkuara. OE ka paraqitur inxhinieren Master të Infrastrukturës Rrugore, Vllora Neziri, e cila nuk ka paraqitur fare Referencë apo ndonjë vërtetim mbi përvojën e punës sipas kërkesës së AK në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Gjithashtu, mungon dëshmia e certifikimit si NVM e kërkuar në dosjen e tenderit.

SQARIM 6:

Tek kontratat dhe data i kemi sqaruar më lartë, është i njëjti pretendim nga Komisioni Vlerësues për të gjithë inxhinierët. Konsorciumi ynë ka propozuar znj. Vllora Neziri, një inxhiniere me kualifikime dhe përvojë profesionale në fushën e infrastrukturës. Fakti që gjatë procesit të skanimit nuk janë përfshirë disa nga dokumentet mbështetëse, përfshirë referencat e saj, nuk e zhbën përvojën, eksperiencën dhe kualifikimet e saj profesionale, të cilat ekzistojnë dhe janë të verifikueshme. Një lëshim teknik gjatë skanimit të dokumenteve nuk mund të interpretohet si mungesë e kapaciteteve profesionale. Për më tepër, konsorciumi ynë e përmbush bindshëm këtë kriter përmes ekspertit tjetër të propozuar, z. Vebi Goxhulli, i cili është Magjistër i Shkencave të Inxhinierisë së Mbrojtjes së Mjedisit dhe posedon kualifikimet akademike e profesionale të kërkuara për realizimin e kontratës. Prandaj, është e paarsyeshme të konstatohet se konsorciumi nuk i plotëson kërkesat e FDT-së, kur në ofertë është paraqitur një ekspert me nivel të avancuar universitar dhe kompetencë profesionale në fushën përkatëse.

Autoriteti Kontraktues është i obliguar ta vlerësojë ofertën në tërësinë e saj dhe jo të nxjerrë përfundime të bazuara vetëm në një mangësi teknike gjatë skanimit të dokumenteve. Duke pasur parasysh se konsorciumi ka propozuar dy ekspertë për këtë pozitë, ndër të cilët z. Vebi Goxhulli, Magjistër i Shkencave të Inxhinierisë së Mbrojtjes së Mjedisit, përmbush në mënyrë të qartë dhe të pakontestueshme kërkesat e Formularit të të Dhënave të Tenderit, konstatimi për mosplotësimin e këtij kriteri është i pambështetur në faktet dhe dokumentacionin e ofertës.

Pretendimi 7: Tek Aneksi 7, LISTA E PAJISJEVE, AK ka kërkuar makinerinë për realizimin e projektit sipas kërkesës së paraqitur në dosjen e tenderit, siç janë:

“Makineria me numër rendor 9. Rimorkio për bartjen e makinerive, peshë bartëse min. 36 t (sasia e kërkuar, copë 1).

OE V-SHEHU SH.P.K. në ofertë ka paraqitur një gjysmë-rimorkio për bartjen e automjeteve me targa: 07-855-AX, me këto specifika të peshave:

40000 Pesha (= pesha bartëse e lejuar, pesha e automjetit)

32000 Pesha bartëse e lejuar (nuk e plotëson kërkesën e AK min. 36 ton)

8000 Pesha e automjetit.

Pra, OE nuk e plotëson kërkesën sipas dosjes së tenderit, konkretisht makinerinë me numër rendor 9. Rimorkio për bartjen e makinerive, peshë bartëse min. 36 t (sasia e kërkuar, copë 1), e cila është e paraqitur nën 36 t dhe e cila nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë."

SQARIM 7:

Libreza e automjetit, e lëshuar nga organi kompetent, është dokument publik dhe zyrtar, i cili qartë dhe pa asnjë dilemë përcakton se pesha maksimale e ngarkesës së lejuar e automjetit është 40,000 kg (40 ton). Pavarësisht këtij fakti të pakontestueshëm, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë një përfundim krejtësisht të kundërt, duke interpretuar dokumentin zyrtar në mënyrë që nuk mbështetet as në përmbajtjen e tij dhe as në ndonjë bazë ligjore.

Është e papranueshme që një dokument zyrtar të interpretohet në kundërshtim me të dhënat që ai përmban. Autoriteti Kontraktues nuk ka kompetencë të ndryshojë, relativizojë apo t'i japë një kuptim tjetër një dokumenti publik të lëshuar nga organi kompetent. Çdo vlerësim duhet të mbështetet në përmbajtjen objektive të dokumenteve të ofertës dhe jo në interpretime subjektive që bien ndesh me provat e paraqitura.

Mënyra se si është trajtuar ky dokument zyrtar dhe e gjithë oferta jonë nga Komisioni i Vlerësimit dhe Menaxheri i Prokurimit nuk është në përputhje me standardin e një vlerësimi objektiv dhe të paanshëm. Në vend që t'u referohen të dhënave zyrtare të librezës së automjetit, ata kanë nxjerrë përfundime që nuk mbështeten në dokumentacionin e ofertës. Një qasje e tillë krijon përshtypjen e një vlerësimi jo të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe cenon besimin në integritetin e procedurës së prokurimit.

Një veprim i tillë bie ndesh me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, veçanërisht me nenin 7, i cili obligon Autoritetin Kontraktues të sigurojë trajtim të barabartë, mosdiskriminim, transparencë dhe konkurrencë të ndershme, si dhe me nenin 59, i cili kërkon që ofertat të shqyrtohen dhe vlerësohen vetëm mbi bazën e dokumentacionit dhe kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha faktet, provat dhe argumentet e paraqitura më sipër, rezulton qartë se vendimi i Autoritetit Kontraktues, Komuna e Pejës, është nxjerrë mbi vlerësime të pabazuara, interpretime të gabuara të dokumentacionit zyrtar dhe në kundërshtim me kërkesat e Formularit të të Dhënave të Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues, Komuna e Pejës – Zyra e Prokurimit, që ta aprovojë këtë kërkesë për rishqyrtim, ta anulojë vendimin për dhënie të kontratës, ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit të eliminojë të gjitha shkeljet dhe gabimet e konstatuara në procesin e vlerësimit, duke bërë një shqyrtim objektiv, të paanshëm dhe në përputhje me dokumentacionin e tenderit dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Pas një rivlerësimi të ligjshëm dhe të drejtë, kërkojmë që konsorciumi ynë N.T. “Fer-Petroll” dhe “V-SHEHU” SH.P.K. të shpallet fitues, pasi është i vetmi konsorcium i përgjegjshëm që i plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe Formularit të të Dhënave të Tenderit, ndërsa njëkohësisht ka paraqitur edhe ofertën ekonomikisht më të favorshme, në vlerë rreth 101,068.63 €, më të ulët se grupi i konsorciumit “Dorearti” Sh.p.k. & “Lani-AL” Sh.p.k., i rekomanduar për dhënie të kontratës.

Konsorciumi ynë, më dt. 27.07.2026, ka paraqitur kërkesë për Rishqyrtim mbi shkeljet e Ligjit të LPP-së, të cilat kanë ndodhur në këtë procedurë të prokurimit, duke i dëshmuar me fakte e argumente të shumta. Po me këtë datë, AK e pezullon aktivitetin në fjalë.

Më dt. 03.08.2026, ne kemi pranuar vendimin e Autoritetit Kontraktues, Komuna e Pejës, ku AK ka parë që ne e kemi hetuar manipulimin e dhënies së projektit dhe dëshiron që të anulojë komplet Lotin 8 me titull: “Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Pejës - LOT 8 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnovë – Gjorë, pjesa II”, me nr. të Prokurimit: 635-26-3347-5-1-1 dhe numër të brendshëm: 635-26-033-511, duke shkelur prapë ligjin e prokurimit, ku, duke u bazuar në ligj, është Neni 62 i Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës – “Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit”. Ku thuhet:

1. Ka ndodhur ose do të ndodhë një shkelje e ligjit që nuk mund të korrigjohet ose parandalohet.

2. Të gjithë tenderët e përgjegjshëm kanë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues.

3. Vetëm para hapjes së tenderëve, kur ndodhin rrethana objektive dhe të paparashikueshme jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues.

Kjo do të thotë se, pas hapjes së ofertave, AK nuk ka të drejtë ta anulojë aktivitetin për arsye si:

- nuk i pëlqen operatori ekonomik i renditur i pari;
- dëshiron ta rishpallë tenderin;
- ndryshim mendimi apo arsye administrative pa bazë ligjore;
- favorizim i një operatori tjetër.

Pas hapjes së ofertave, anulimi lejohet vetëm nëse ekziston një nga bazat e Nenit 62 (shkelje e pariparueshme e ligjit ose tejkalim substancial i buxhetit, ose kur një dispozitë tjetër e ligjit kërkon anulimin). Çdo vendim tjetër, pa adresuar shkeljet dhe parregullsitë e evidentuara në këtë kërkesë për rishqyrtim, do të ishte në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë, trajtimit të barabartë, transparencës dhe mbrojtjes së interesit publik, siç përcaktohen në Ligjin për Prokurimin Publik.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 62 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues mund ta përfundojë (anulojë) një aktivitet të prokurimit pa dhënë kontratë vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht me ligj. Këto raste janë përjashtimore dhe duhet të arsyetohen me fakte konkrete dhe prova.

Në rastin konkret, aktiviteti i prokurimit është anuluar pas hapjes së ofertave, ndërsa Autoriteti Kontraktues nuk ka dëshmuar ekzistencën e ndonjërës prej bazave ligjore të parashikuara në nenin 62 të LPP-së. Vendimi nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm që të vërtetojë se ka ekzistuar një shkelje e pariparueshme e ligjit, se çmimet e ofertave të përgjegjshme e tejkalojnë në mënyrë substanciale buxhetin e planifikuar, apo ndonjë bazë tjetër ligjore që do ta justifikonte anulimin.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues është i mangët, i paarsyetuar dhe në kundërshtim me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe administrimit të drejtë të procedurës së prokurimit.

Autoriteti Kontraktues nuk është marrë fare me sqarimet dhe argumentet e paraqitura nga Konsorciumi ynë. Në vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk është bërë asnjë analizë e pretendimeve tona, nuk janë vlerësuar provat e dorëzuara dhe nuk është dhënë asnjë arsyetim se përse ato janë konsideruar të pabazuara. Mosshqyrtimi i sqarimeve të operatorit ekonomik përbën shkelje të detyrimit të Autoritetit Kontraktues për të marrë një vendim të arsyetuar dhe të bazuar në faktet e rastit.

Për më tepër, në njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit, Autoriteti Kontraktues nuk i ka dhënë Konsorciumit tonë asnjë arsye konkrete dhe të individualizuar se përse është konsideruar operator i papërgjegjshëm. Vendimi nuk përmban analizë faktike dhe juridike mbi dokumentacionin e dorëzuar nga Konsorciumi ynë, por kufizohet në konstatime të përgjithshme, pa identifikuar dispozitat ligjore të shkelura dhe pa shpjeguar se në çfarë mënyre ato do ta bënin ofertën tonë të papërgjegjshme.

Një vendim administrativ që prek të drejtat dhe interesat e operatorëve ekonomikë duhet të jetë i arsyetuar në mënyrë të plotë, të qartë dhe konkrete. Arsyetimi duhet t'i mundësojë operatorit ekonomik të kuptojë bazën faktike dhe juridike të vendimit, si dhe t'i mundësojë ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit.

Në rastin konkret, kjo nuk ka ndodhur. Vendimi i Autoritetit Kontraktues është i mangët, i njëanshëm dhe i paarsyetuar, duke mos përmbushur standardin ligjor për një vendim të bazuar në prova dhe në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik. Për këtë arsye, i njëjti duhet të anulohet si i kundërligjshëm.

Duke u bazuar në faktet e paraqitura, provat e administruara dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ankesën tonë ta aprovojë si të bazuar, të anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lëndën ta kthejë në rivlerësim.

Gjithashtu, kërkojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese, të vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve dhe vendimit të Autoritetit Kontraktues dhe të obligojë këtë të fundit që gjatë rivlerësimit të bëjë një vlerësim të plotë, objektiv dhe në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, duke marrë në konsideratë të gjitha provat dhe sqarimet e paraqitura nga Konsorciumi ynë.

Meqenëse oferta e Konsorciumit tonë është oferta e vetme e përgjegjshme dhe me çmimin më të ulët, kërkojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas shqyrtimit të pretendimeve tona dhe konstatimit të ligjshmërisë së ofertës së Konsorciumit, të obligojë Autoritetin Kontraktues që, pas rivlerësimit të ligjshëm të procedurës, ta shpallë Konsorciumin tonë fitues dhe t'i japë

kontratën, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet janë të pakalkuluara për momentin. Dëmet janë të pariparueshme, sepse ne jemi të vetmit OE të përgjegjshëm dhe më të lirë, të cilët kemi krijuar shpenzime dhe jemi përgatitur për kryerjen e këtyre punimeve.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Pretendimet e paraqitura nga Operatori Ekonomik N.T. "Fer-Petroll" & "V-SHEHU" SH.P.K. në ankesën e tyre nuk qëndrojnë dhe nuk mbështeten në gjendjen faktike dhe juridike të krijuar gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Fillimisht, duhet theksuar se Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar në tërësi Kërkesën për Rishqyrtim të paraqitur nga Operatori Ekonomik N.T. "Fer-Petroll" & "V-SHEHU" SH.P.K., të dorëzuar më datë 27.07.2026, ora 11:52, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar atë pjesërisht të bazuar, jo për shkak se janë pranuar pretendimet e operatorit ekonomik se ai i plotëson të gjitha kriteret e kualifikimit, por për shkak se janë evidentuar çështje që kërkonin rivlerësim të plotë të procedurës së prokurimit. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues ka emëruar Komision të Ri të Rivlerësimit, me qëllim që të bëhej një shqyrtim i plotë, objektiv dhe i paanshëm i dokumentacionit të të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Pas rivlerësimit të plotë të procedurës, Komisioni Rivlerësues ka konstatuar se as Grupi i Operatorëve Ekonomikë "DOREARTI" SH.P.K. & "Lani-AL" SH.P.K. dhe as Grupi i Operatorëve Ekonomikë N.T. "Fer-Petroll" & "V-SHEHU" SH.P.K. nuk i plotësojnë kërkesat e detyrueshme të Dosjes së Tenderit, Formularit të të Dhënave të Tenderit (FDT) dhe Njoftimit për Kontratë. Për rrjedhojë, nga rivlerësimi është konstatuar se nuk ekziston asnjë operator ekonomik i përgjegjshëm, në kuptim të nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i cili obligon Autoritetin Kontraktues që ofertat ti shqyrtojë dhe vlerësojë vetëm mbi bazën e kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Pretendimi i Operatorit Ekonomik N.T. "Fer-Petroll" & "V-SHEHU" SH.P.K. se Autoriteti Kontraktues ka anuluar aktivitetin e prokurimit vetëm për të mos e shpallur atë fitues është plotësisht i pabazuar dhe nuk mbështetet në asnjë provë. Përkundrazi, vendimi për anulimin e aktivitetit është rezultat i drejtpërdrejtë i konstatimeve të Komisionit Rivlerësues, i cili ka vlerësuar se asnjë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës nuk i plotëson kriteret e detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

Në mënyrë konkrete, lidhur me ofertën e Grupit të Operatorëve Ekonomikë N.T. "Fer-Petroll" & "V-SHEHU" SH.P.K., Komisioni Rivlerësues ka konstatuar këto mospërputhje:

1. Gjeodet (Bachelor), minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit

Në vend të kontratës ose parakontratës në emër të projektit, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, është paraqitur vetëm Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional. Marrëveshja nuk përmban elementet thelbësore të një kontrate pune, siç janë orari i punës, kohëzgjatja e angazhimit dhe paga. Marrëveshja mban datën 03.07.2027, prandaj nuk mund të konsiderohet dokument valid në momentin e dorëzimit të ofertës. Nuk janë paraqitur referenca apo dëshmi të tjera që provojnë minimumin prej tre viteve përvojë pune pas diplomimit.

2. Inxhinier i Arkitekturës (Bachelor)

Është paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional në vend të kontratës ose parakontratës. Marrëveshja nuk përmban elementet obligative të kontratës së punës. Marrëveshja është me datë 03.07.2027, prandaj nuk mund të konsiderohet dokument valid.

3. Inxhinier i Ndërtimtarisë/Konstruktiv (Bachelor)

Është paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional në vend të kontratës ose parakontratës. Marrëveshja nuk përmban elementet esenciale të kontratës së punës. Marrëveshja mban datën 03.07.2027. Nuk janë paraqitur referenca, vërtetime nga punëdhënësi apo dëshmi nga Trusti që provojnë minimumin prej tre viteve përvojë pune. Nga dokumentacioni rezulton se kandidati është diplomuar më 22.11.2018, ndërsa nuk janë paraqitur dëshmi të tjera që provojnë përvojën profesionale të kërkuar.

4. Master i Shkencave në Xehetari, i specializuar për Shpim-Plasje

Është paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional në vend të kontratës ose parakontratës. Marrëveshja nuk përmban elementet obligative të kontratës. Marrëveshja është me datë 03.07.2027. Nuk është dëshmuar specializimi i kërkuar në fushën Shpim-Plasje. Nuk janë paraqitur dëshmi të mjaftueshme për përvojën profesionale pas diplomimit. Mungon CV-ja profesionale, e kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

5. Master i Infrastrukturës Rrugore, i certifikuar si NVM

Është paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional në vend të kontratës ose parakontratës. Marrëveshja nuk përmban elementet e domosdoshme të kontratës. Marrëveshja është me datë 03.07.2027. Mungojnë referencat ose dëshmitë për përvojën profesionale. Mungon Certifikata NVM e kërkuar në Dosjen e Tenderit.

6. Inxhinier i Ambientit, i certifikuar si NVM

Është paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional dhe jo kontratë ose parakontratë. Marrëveshja nuk përmban elementet obligative të kontratës së punës. Marrëveshja është me datë 03.07.2027. CV-ja nuk është e nënshkruar.

Nga dokumentacioni rezulton se kandidati është njëkohësisht i angazhuar si Profesor Asistent në UBT, në dy fakultete, në kompaninë private "Golden Consulting Centre" SH.P.K. dhe si ekspert gjyqësor për mjedis, ndërsa nuk është paraqitur asnjë dëshmi që provon disponueshmërinë e tij efektive për realizimin e këtij projekti.

Aneksi 7 – Lista e Pajisjeve

Dosja e Tenderit ka kërkuar një rimorkio për bartjen e makinerive me peshë bartëse minimale prej 36 ton. Operatori Ekonomik ka paraqitur një gjysmë-rimorkio me targa 07-855-AX, nga dokumentacioni i së cilës rezulton:

- Pesha totale e lejuar: 40,000 kg;
- Pesha bartëse e lejuar: 32,000 kg;
- Pesha vetanake: 8,000 kg.

Komisioni Rivlerësues ka konstatuar se pesha bartëse prej 32 ton nuk e plotëson kërkesën minimale prej 36 ton, të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, ku për më shumë mund të shihni edhe Librezën e rimorkios me tabela 07-855-AX, prandaj pajisja nuk i plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

SAT S0/32

161

-SHEH SHRK

Nga të gjitha konstatimet e mësipërme rezulton qartë se edhe Grupi i Operatorëve Ekonomikë N.T. "Fer-Petroll" & "V-SHEHU" SH.P.K. nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kritereve të detyrueshme të kualifikimit.

Për këtë arsye, pretendimi i këtij operatori ekonomik se është "operatori i vetëm i përgjegjshëm" nuk qëndron, pasi është rrëzuar nga vetë rezultatet e rivlerësimit.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur bazë ligjore që kontratën tia japë ndonjë operatori ekonomik, pasi një veprim i tillë do të ishte në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe me parimet themelore të nenit 7 të këtij ligji, që garantojnë trajtim të barabartë, transparencë, proporcionalitet dhe konkurrencë të drejtë.

Rrjedhimisht, vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit është marrë pas një rivlerësimi të plotë, objektiv dhe të paanshëm dhe përfaqëson zbatimin korrekt të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, pasi nga rivlerësimi është konstatuar se asnjë operator ekonomik nuk i plotësonte në tërësi kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Për rrjedhojë, pretendimet e Operatorit Ekonomik N.T. "Fer-Petroll" & "V-SHEHU" SH.P.K. janë të pabazuara si në aspektin faktik, ashtu edhe në atë juridik dhe nuk krijojnë asnjë bazë ligjore për ndryshimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 19.08.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0606, ndërsa me datë 27.08.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0606, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërishtë e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e

ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE N.T. „Fer-Petroll, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0430 ka vlerësuar si në vijim:

Arsyeja e eliminimit nr. 1 – Bachelor i Gjeodezisë – Autoriteti Kontraktues:

Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se për Bachelorin e Gjeodezisë, OE nuk ka paraqitur kontratë ose parakontratë në emër të projektit, siç ishte kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, por ka dorëzuar një Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional. Sipas AK-së, marrëveshjes i mungojnë elemente bazë të kontratës, përfshirë orarin e punës dhe vlerën e pagesës, ndërsa ajo mban datën 03.07.2027, që sipas AK-së nënkupton se nuk ishte aktive në periudhën relevante të procedurës. Gjithashtu, AK ka konstatuar se OE nuk ka paraqitur referencë pune për të dëshmuar minimumin prej 3 viteve përvojë pune pas diplomimit, sipas kërkesës së DT-së dhe NJK-së.

Pretendimi nr. 1 – Bachelor i Gjeodezisë – GOE-ankues:

OE ankues kundërshton eliminimin lidhur me ekspertin Bachelor të Gjeodezisë. GOE, pretendon se Marrëveshja për Bashkëpunim Profesional e dorëzuar duhet të konsiderohet dokument ekuivalent me kontratën apo parakontratën, pasi sipas tij ajo dëshmon disponueshmërinë dhe angazhimin e ekspertit për realizimin e projektit. Për datën 03.07.2027 të shënuar në marrëveshje, GOE deklaron se bëhet fjalë për gabim teknik. Sa i përket referencave për përvojën e punës, ankuesi pretendon se ato nuk janë përfshirë gjatë skanimit të dokumentacionit dhe se AK ka pasur mundësi të kërkojë sqarime apo informacione shtesë. Gjithashtu, OE thekson se përvoja mund të dëshmohej edhe përmes dëshmisë së Trustit Pensional, të cilën pretendon se e ka bashkëngjitur.

Përgjigjje në pretendimin -1 (e parë)

Kërkesa e autoritetit kontraktues lidhur për bachelorin e Gjeodezisë ka kërkuar që kërkesa të plotësohet sipas kërkesës si në vazhdim:

Kërkesa:

3.Bachelor i Gjeodezisë, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

për secilin anëtar të stafit duhet të dorëzohen këto dëshmi: Diploma universitare përkatëse (Bachelor ose Master); CV profesionale e nënshkruar; Certifikata licenca profesionale përkatëse, aty ku kërkohet; Certifikata NVM, për pozitat ku kërkohet; Dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrat ne emer te projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti). sipas viteve të kërkuara.

SQARIMI:

GOE-ankues në dëshminë e ofruar me ofertë, ka ofruar marrëveshje bashkëpunimi, për stafin - bachelor i gjeodozisë, poashtu data e lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit është me datë: 03.07.2026.

Poashtu janë evidente edhe mungesa e elementeve të marrëveshjes së bashkpunimit edhe vlera e pagesës dhe orarin e punës, edhe pse nuk është specifikuar në kërkesën e AK, forma e marrëveshjes së bashkpunimit si një dokument i cili përmban marrëveshje me të drejta dhe detyrime dhe një akt juridik do të duheshin të jenë të pasqyruara.

Lidhur me çështjen se AK ka kërkuar Kontratë apo parakontratë, AK e ka specifikuar edhe emërtimin e lidhjes: Kontratë ose Parakontratë, kurse GOE ka ofruar marrëveshje. Në bazë të emërtimit dokumenti nuk e ka emërtimin e njëjtë, megjithëatë ka elemente brenda marrëveshjes që në mënyrë objektive bëhet fjalë për të njëjtin projekt, poashtu është specifikuar edhe pozita e e bachelorit të gjedodozisë ku në mënyrë objektive vertetohet se bëhet fjalë për të njëjtin projekt, mirëpo data e lidhjes së marrëveshjes paraqet efekt juridik se kur bëhet i plotëfuqishëm dokumenti dhe data e lidhjes së marrëveshjes është lidhur me datë: 03.07.2026, kurse hapja e ofertave ka qenë me datë: 22.06.2026 ku gjatë fazës së vlerësimit deri me datë 03.07.2026 marrëveshja nuk ka qenë në fuqi dhe në anën tjetër kërkesa e AK ka qenë që stafi të ketë kontratë apo parakontratë, nënkupton se data e kontratës apo parakontratës duhet të jetë para datës së hapjes së ofertave, poashtu mungesa e deklaruar e pagesës paraqet dokument me elemente me mangësi dhe çdo kërkesë për sqarim apo modifikim mund të konsiderohet edhe si ndryshim material.

Kurse sa i përketë pjesës së përvojës së punës për Bachelorin e Gjeodozisë GOE, e ka ofruar trustin pensional dhe i njëjti është valid sipas kërkesës së autoritetit kontraktues.

PRETENDIMI I PARË I GOE-ANKUES ËSHTË I PABAZUAR

Arsyeja e eliminimit nr. 2 – Inxhinieri i Ambientit - Autoriteti Kontraktues:

Për Inxhinierin e Ambientit, z. Ibush Luzha, AK ka konstatuar se OE ka paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional në vend të kontratës ose parakontratës, e cila, sipas AK-së, nuk përmban elementet bazë të kontratës dhe mban datën 03.07.2027. Përveç kësaj, AK ka konstatuar se CV-ja e ekspertit nuk është e nënshkruar, ndonëse kjo ishte kërkuar në dokumentet e tenderit. AK ka marrë parasysh edhe faktin se nga CV-ja rezulton se eksperti është i angazhuar në UBT, në kompaninë Golden Consulting Center SH.P.K. dhe si ekspert gjyqësor për mjedis, duke vlerësuar se, për shkak të këtyre angazhimeve, nuk dëshmohet mundësia e angazhimit të tij edhe në projektin konkret.

Pretendimi nr. 2 – Inxhinieri i Ambientit- GOE-ankues:

OE ankues kundërshton arsyen e eliminimit lidhur me Inxhinierin e Ambientit, z. Ibush Luzha. Sipas ankuesit, mungesa e nënshkrimit në CV është mangësi formale, e cila nuk ndikon në kualifikimet, përvojën apo disponueshmërinë e ekspertit. Ankuesi pretendon se këto elemente janë dëshmuar përmes dokumenteve të tjera të ofertës. Po ashtu, kundërshton konstatimin e AK-së se angazhimet e ekspertit në UBT, në kompaninë e tij dhe si ekspert gjyqësor e pamundësojnë angazhimin në projekt, duke argumentuar se legjislacioni nuk e ndalon një person të jetë i angazhuar te më shumë se një punëdhënës.

Përgjigjje në pretendimin -2 (e dytë)

Kërkesa e autoritetit kontraktues lidhur me inxhinierin e ambinetit ëhtë:

Kërkesa:

6.Inxhinier i Ambientit, i certifikuar si NVM, me minimum 5 vite përvojë pune – pas diplomimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Për secilin anëtar të stafit duhet të dorëzohen këto dëshmi: Diploma universitare përkatëse (Bachelor ose Master); CV profesionale e nënshkruar; Certifikata licenca profesionale përkatëse, aty ku kërkohet; Certifikata NVM, për pozitat ku kërkohet; Dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrat ne emer te projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti). sipas viteve të kërkuara.

SQARIMI:

Lidhur me çështjen se AK, ka kërkuar Kontratë apo parakontratë, AK e ka specifikuar edhe emërtimin e lidhjes: Kontratë ose Parakontratë, kurse GOE ka ofruar marrëveshje. Në bazë të emërtimit dokumenti nuk e ka emërtimin e njëjtë, megjithëatë ka elemente brenda marrëveshjes që në mënyrë objektive bëhet fjalë për të njëjtin projekt, poashtu është specifikuar edhe pozita e Inxhinierin e Ambinetit, ku në mënyrë objektive vertetohet se bëhet fjalë për të njëjtin projekt, mirëpo data e lidhjes së marrëveshjes paraqet efekt juridik se kur bëhet i plotëfuqishëm dokumenti, dhe data e marrëveshjes e lidhur është me datë: 03.07.2026 kurse hapja e ofertave ka qenë me datë: 22.06.2026 ku gjatë fazës së vlerësimit deri me datë 03.07.2026 marrëveshja nuk ka qenë në fuqi dhe në anën tjetër kërkesa e AK ka qenë që stafi të ketë kontrat apo parakontratë, nënkupton se data e kontratës apo parakontratës duhet të jetë para datës së hapjes së ofertave, poashtu mungesa e deklaruar e pagesës paraqet dokument me elemente me mangësi dhe çdo kërkesë për sqarim apo modifikim mund të konsiderohet edhe si ndryshim material.

Lidhur me çështjen e nënshkrimit të CV -së, për Inxhninierin e Ambinetit se nuk është nënshkruar, sqaroj se kërkesa e AK lidhur me CV, është: CV profesionale e nënshkruar; .

Në dëshminë e ofruar -CV-në, për Inxhinierin e Ambientit GOE, edhe në pretendimin e tij konfirmon se CV, nuk është nënshkruar dhe se është gabim formal. Po ashtu gjatë verifikimit të CV-së, të dorëzuar me ofertë për Inxhinerin e Ambinetit konfirmoj se e njëjta nuk është e nënshkruar. Pasi që kërkesa e aurtoritetit kontraktues ka qenë specifike dhe e qartë dhe dëshmia nuk e përmbush kërkesat minimale të spefifikuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë vlerësoj se kërkesa nuk është përmbushur.

PRETENDIMI I DYTË I GOE-ANKUES ËSHTË I PABAZUAR

Arsyeja e eliminimit nr. 3 – Inxhinieri Arkitekt - Autoriteti Kontraktues:

Për Inxhinierin Arkitekt, AK ka konstatuar se OE nuk ka paraqitur kontratë ose parakontratë në emër të projektit, por Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional. Sipas AK-së, kjo marrëveshje nuk i përmban elementet bazë të një kontrate, konkretisht orarin e punës dhe vlerën e pagesës. Po ashtu, marrëveshja figuron me datën 03.07.2027, për çka AK ka vlerësuar se ajo nuk mund të konsiderohet aktive dhe e vlefshme për angazhimin e ekspertit në procedurën konkrete.

Pretendimi nr. 3 – Inxhinieri Arkitekt - GOE-ankues:

OE ankues kundërshton eliminimin lidhur me Inxhinierin Arkitekt. Ankuesi pretendon se arsyeja e përdorur nga AK është e njëjtë me atë për ekspertët e tjerë, përkatësisht se është paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional në vend të kontratës ose parakontratës dhe se marrëveshja mban datën 03.07.2027. OE i referohet sqarimit të dhënë në pretendimin nr. 1, duke konsideruar marrëveshjen e bashkëpunimit dokument të mjaftueshëm për të dëshmuar disponueshmërinë e ekspertit dhe datën e gabuar si gabim teknik.

Përgjigjje në pretendimin -3 (e tretë)

Kërkesa e autoritetit kontraktues lidhur me Inxhinierin Arkitekt është:

2. Inxhinier i Arkitekt, Bachelor, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Për secilin anëtar të stafit duhet të dorëzohen këto dëshmi: Diploma universitare përkatëse (Bachelor ose Master); CV profesionale e nënshkruar; Certifikata licenca profesionale përkatëse, aty ku kërkohet; Certifikata NVM, për pozitat ku kërkohet; Dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrat ne emer te projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti). sipas viteve të kërkuara.

SQARIMI:

Lidhur me çështjen se AK, ka kërkuar Kontratë apo parakontratë, AK e ka specifikuar edhe emërtimin e lidhjes: Kontratë ose Parakontratë, kurse GOE ka ofruar marrëveshje. Në bazë të emërtimit dokumenti nuk e ka emërtimin e njëjtë, megjithëatë ka elemente brenda marrëveshjes që në mënyrë objektive bëhet fjalë për të njëjtin projekt, poashtu është specifikuar edhe pozita e Inxhinierin e Arkitetit, ku në mënyrë objektive vertetohet se bëhet fjalë për të njëjtin projekt, mirëpo data e lidhjes së marrëveshjes paraqet efekt juridik se kur bëhet i plotëfuqishëm dokumenti, dhe data e marrëveshjes e lidhur është me datë: 03.07.2026 kurse hapja e ofertave ka qenë me datë: 22.06.2026 ku gjatë fazës së vlerësimit deri me datë 03.07.2026 marrëveshja nuk ka qenë në fuqi dhe në anën tjetër kërkesa e AK ka qenë që stafi të ketë kontratë apo parakontratë, nënkupton se data e kontratës apo parakontratës duhet të jetë para datës së hapjes së ofertave, poashtu mungesa e deklaruar e pagesës paraqet dokument me elemente me mangësi dhe çdo kërkesë për sqarim apo modifikim mund të konsiderohet edhe si ndryshim material.

PRETENDIMI I TRETË I GOE-ANKUES ËSHTË I PABAZUAR

Arsyeja e eliminimit nr. 4 – Inxhinieri i Ndërtimtarisë-Konstruktiv - Autoriteti Kontraktues:

Për Inxhinierin e Ndërtimtarisë-Konstruktiv, AK ka konstatuar fillimisht të njëjtën mangësi lidhur me paraqitjen e Marrëveshjes për Bashkëpunim Profesional në vend të kontratës ose parakontratës, si dhe datën 03.07.2027 të kësaj marrëveshjeje. Përveç kësaj, AK ka konstatuar se OE nuk ka dëshmuar minimumin prej 3 viteve përvojë pune pas diplomimit me referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti. Sipas vlerësimit të AK-së, nga diploma dhe CV-ja e paraqitur rezultonte se eksperti kishte përfunduar studimet më 22.11.2018, ndërsa CV-ja ishte e nënshkruar në vitin 2019, nga çka AK ka konsideruar se dëshmohej vetëm rreth 13 muaj përvojë dhe se nuk ishin paraqitur dëshmi të tjera për përvojën e kërkuar.

Pretendimi nr. 4 – Inxhinieri i Ndërtimtarisë-Konstruktiv - GOE-ankues:

OE ankues kundërshton konstatimin e AK-së se Inxhinieri i Ndërtimtaris-Konstruktiv nuk ka dëshmuar minimumin prej 3 viteve përvojë pune pas diplomimit. Ankuesi pretendon se referencat e ekspertit nuk janë përfshirë gjatë skanimit të dokumentacionit dhe se AK, në vend të eliminimit, ka mundur të kërkojë sqarime dhe dokumente shtesë lidhur me përvojën. OE deklaron se dokumentacioni përkatës do ti bashkëngjitej kërkesës për rishqyrtim, ndërsa edhe për marrëveshjen e bashkëpunimit dhe datën e saj i referohet sqarimeve të dhëna më herët.

Përgjigjje në pretendimin -4 (e katërt)

Kërkesa:

Inxhinieri i Ndërtimtarisë-Konstruktiv

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Për secilin anëtar të stafit duhet të dorëzohen këto dëshmi: Diploma universitare përkatëse (Bachelor ose Master); CV profesionale e nënshkruar; Certifikata licenca profesionale përkatëse, aty ku kërkohet; Certifikata NVM, për pozitat ku kërkohet; Dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrat ne emer te projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti). sipas viteve të kërkuara.

SQARIMI:

Lidhur me çështjen se AK, ka kërkuar Kontratë apo parakontratë, AK e ka specifikuar edhe emërtimin e lidhjes: Kontratë ose Parakontratë, kurse GOE ka ofruar marrëveshje. Në bazë të emërtimit dokumenti nuk e ka emërtimin e njëjtë, megjithëatë ka elemente brenda marrëveshjes që në mënyrë objektive bëhet fjalë për të njëjtin projekt, poashtu është specifikuar edhe pozita e Inxhinieri i Ndërtimtarisë-Konstruktiv , ku në mënyrë objektive vertetohet se bëhet fjalë për të njëjtin projekt, mirëpo data e lidhjes së marrëveshjes paraqet efekt juridik se kur bëhet i plotëfuqishëm dokumenti, dhe data e marrëveshjes e lidhur është me datë: 03.07.2026 kurse hapja e ofertave ka qenë me datë: 22.06.2026 ku gjatë fazës së vlerësimit deri me datë 03.07.2026 marrëveshja nuk ka qenë në fuqi dhe në anën tjetër kërkesa e AK ka qenë që stafi të ketë kontrat apo parakontratë, nënkupton se data e kontratës apo parakontratës duhet të jetë para datës së hapjes së ofertave, poashtu mungesa e deklaruar e pagesës paraqet dokument me elemente me mangësi dhe çdo kërkesë për sqarim apo modifikim mund të konsiderohet edhe si ndryshim material.

Kurse lidhur me dëshmitë për përvojën e punës siç ka kërkuar AK se përvoja e punës duhet të llogaritet nga data pas diplomimit, për pozitën e njëjtë sqaroj se lidhur me përvojën e punës është

lëshuar një referencë e cila nuk përmban datën e lëshimit por vetëm si vit për përvojën e punës duke deklaruar se nga viti 2011, megjithëatë lidhur me përvojën e punës AK ka mundur të kërkojë sqrim shtesë në bazë të nenit 72. Pasi që brenda këtij pretendimi është pjesa e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe janë vlerësuar si të pabazuara edhe pretendimi numër katër është i pabazuar.

PRETENDIMI I KATËRT I GOE-ANKUES ËSHTË I PABAZUAR

Arsyeja e eliminimit nr. 5 – Master i Shkencave në Xehetari – Autoriteti Kontraktues:

Për ekspertin z. Xhevdet Kastrati, AK ka konstatuar disa mangësi. Fillimisht, edhe për këtë ekspert është paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional në vend të kontratës ose parakontratës, e cila mban datën 03.07.2027. Në aspektin profesional, AK ka konstatuar se eksperti i propozuar nuk ka dëshmuar specializimin për shpim-plasje, siç ishte kërkuar në DT dhe NJK. Sipas AK-së, dokumentet tregojnë diplomimin në vitin 2010, ndërsa nuk janë paraqitur dëshmi të mjaftueshme për përvojën pas diplomimit; përvoja e dokumentuar për periudhën 2004–2007 është para diplomimit, ndërsa referencave të tjera u mungojnë periudhat konkrete të punës. Gjithashtu, AK ka konstatuar se për ekspertin nuk është paraqitur fare CV-ja profesionale, e kërkuar sipas dokumenteve të tenderit.

Pretendimi nr. 5 – Master i Shkencave në Xehetari - GOE-ankues:

OE ankues kundërshton konstatimin e AK-së se eksperti z. Xhevdet Kastrati nuk është i specializuar për shpim-plasje dhe nuk posedon përvojën e kërkuar. Ankuesi pretendon se eksperti është Master i Shkencave në Xehetari, posedon përvojë shumëvjeçare dhe është i certifikuar nga KPMM që nga 18.01.2007. Po ashtu, OE thekson se vetë Komuna e Pejës kishte bashkëpunuar me ekspertin gjatë viteve 2004–2007 dhe i kishte lëshuar referenca. Sipas ankuesit, këto dokumente dëshmojnë kualifikimin dhe përvojën profesionale të ekspertit. Ankuesi gjithashtu thekson se për këtë pozitë kishte propozuar edhe një ekspert tjetër, z. Islam Ahmeti, dhe konsideron se në tërësi kapaciteti profesional i kërkuar është përmbushur.

Përgjigjje në pretendimin -5 (e pestë)

Kërkesa e autoritetit kontraktues është:

Master i Shkencave në Xehetari

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Për secilin anëtar të stafit duhet të dorëzohen këto dëshmi: Diploma universitare përkatëse (Bachelor ose Master); CV profesionale e nënshkruar; Certifikata licenca profesionale përkatëse, aty ku kërkohet; Certifikata NVM, për pozitat ku kërkohet; Dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrat ne emer te projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti). sipas viteve të kërkuara.

SQARIMI:

Lidhur me çështjen se AK, ka kërkuar Kontratë apo parakontratë, AK e ka specifikuar edhe emërtimin e lidhjes: Kontratë ose Parakontratë, kurse GOE ka ofruar marrëveshje. Në bazë të emërtimit dokumenti nuk e ka emërtimin e njëjtë, megjithëatë ka elemente brenda marrëveshjes që në mënyrë objektive bëhet fjalë për të njëjtin projekt, poashtu është specifikuar edhe pozita e

Master i Shkencave në Xehetari , ku në mënyrë objektive vertetohet se bëhet fjalë për të njëjtin projekt, mirëpo data e lidhjes së marrëveshjes paraqet efekt juridik se kur bëhet i plotëfuqishëm dokumenti, dhe data e marrëveshjes e lidhur është me datë: 03.07.2026 kurse hapja e ofertave ka qenë me datë: 22.06.2026 ku gjatë fazës së vlerësimit deri me datë 03.07.2026 marrëveshja nuk ka qenë në fuqi dhe në anën tjetër kërkesa e AK ka qenë që stafi të ketë kontrat apo parakontratë, nënkupton se data e kontratës apo parakontratës duhet të jetë para datës së hapjes së ofertave, poashtu mungesa e deklaruar e pagesës paraqet dokument me elemente me mangësi dhe çdo kërkesë për sqarim apo modifikim mund të konsiderohet edhe si ndryshim material.

Lidhur me pjesën e pretendimit për përvojën e punës, stafi për pozitën Master i Shkencave në Xehtari, ka diplomuar me datë: 24 Nëntor 20210. kurse Referncat i ka të viteve 2007. Lidhur me dorëzimin e CV-së gjatë verifikimit në ofertën e GOE-ankues, nuk është ofruar CV për të njëjtin.

PRETENDIMI I PESTË I GOE-ANKUES ËSHTË I PABAZUAR

Arsyeja e eliminimit nr. 6 – Master i Infrastrukturës Rrugore, i certifikuar NVM - Autoriteti Kontraktues:

Për znj. Vlora Neziri, AK ka konstatuar se OE ka paraqitur Marrëveshje për Bashkëpunim Profesional në vend të kontratës ose parakontratës dhe se marrëveshja mban datën 03.07.2027. Përveç kësaj, AK ka konstatuar se për eksperten nuk është paraqitur asnjë referencë apo vërtetim për përvojën e punës, sipas kërkesave të DT-së dhe NJK-së. Gjithashtu, sipas AK-së, mungon edhe dëshmia e certifikimit si NVM, e cila ishte kërkesë për këtë pozitë. Për këto arsye, AK ka vlerësuar se dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon plotësimin e kërkesave të përcaktuara për këtë ekspert.

Pretendimi nr. 6 – Master i Infrastrukturës Rrugore, i certifikuar NVM - GOE-ankues:

OE ankues kundërshton konstatimin e AK-së lidhur me znj. Vlora Neziri, për të cilën AK kishte konstatuar mungesë të referencave/vërtetimeve për përvojën e punës dhe mungesë të dëshmisë së certifikimit NVM. Ankuesi pretendon se disa dokumente mbështetëse, përfshirë referencat, nuk janë përfshirë gjatë procesit të skanimit, dhe se një lëshim i tillë teknik nuk duhet të interpretohet si mungesë e përvojës apo e kapaciteteve profesionale. OE pretendon gjithashtu se kishte propozuar edhe ekspert tjetër dhe, sipas tij, oferta në tërësi dëshmon kapacitet të mjaftueshëm profesional.

Përgjigjje në pretendimin -6 (e gjashtë)

Kërkesa e autoritetit kontraktues është:

Master i Infrastrukturës Rrugore, i certifikuar si NVM, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Për secilin anëtar të stafit duhet të dorëzohen këto dëshmi: Diploma universitare përkatëse (Bachelor ose Master); CV profesionale e nënshkruar; Certifikata licenca profesionale përkatëse, aty ku kërkohet; Certifikata NVM, për pozitat ku kërkohet; Dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrat ne emer te projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti). sipas viteve të kërkuara.

SQARIMI:

Lidhur me çështjen se AK, ka kërkuar Kontratë apo parakontratë, AK e ka specifikuar edhe emërtimin e lidhjes: Kontratë ose Parakontratë, kurse GOE ka ofruar marrëveshje. Në bazë të emërtimit dokumenti nuk e ka emërtimin e njëjtë, megjithëatë ka elemente brenda marrëveshjes që në mënyrë objektive bëhet fjalë për të njëjtin projekt, poashtu është specifikuar edhe pozita e Master i Infrastrukturës Rrugore, i certifikuar si NVM , ku në mënyrë objektive vertetohet se bëhet fjalë për të njëjtin projekt, mirëpo data e lidhjes së marrëveshjes paraqet efekt juridik se kur bëhet i plotëfuqishëm dokumenti, dhe data e marrëveshjes e lidhur është më datë: 03.07.2026 kurse hapja e ofertave ka qenë me datë: 22.06.2026 ku gjatë fazës së vlerësimit deri me datë 03.07.2026 marrëveshja nuk ka qenë në fuqi dhe në anën tjetër kërkesa e AK ka qenë që stafi të ketë kontrat apo parakontratë, nënkupton se data e kontratës apo parakontratës duhet të jetë para datës së hapjes së ofertave, poashtu mungesa e deklaruar e pagesës paraqet dokument me elemente me mangësi dhe çdo kërkesë për sqarim apo modifikim mund të konsiderohet edhe si ndryshim material.

Sqaroj se GOE-ankues për stafin Master i infrastrukturës Rrugore nuk ka ofruar çertifikatën NVM, poashtu nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me përvojën e punës.

PRETENDIMI I GJASHTË I GOE-ANKUES ËSHTË I PABAZUAR

Arsyeja e eliminimit nr. 7 – Rimorkio për bartjen e makinerive, minimum 36 ton – Autoriteti Kontraktues:

Në kuadër të Aneksit 7 – Lista e Pajisjeve, AK kishte kërkuar një rimorkio për bartjen e makinerive me peshë bartëse minimale 36 ton. OE V-SHEHU SH.P.K. ka paraqitur gjysmërimorkion me targa 07-855-AX. Sipas interpretimit të dokumentacionit nga AK, të dhënat e mjetit tregojnë 40,000 kg peshë të përgjithshme, 32,000 kg peshë bartëse të lejuar dhe 8,000 kg peshë të automjetit. Për këtë arsye, AK ka konstatuar se pesha bartëse e mjetit është 32 ton dhe jo minimumi 36 ton i kërkuar, duke vlerësuar se pajisja e paraqitur nuk e përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Pretendimi nr. 7 – Rimorkio për bartjen e makinerive, minimum 36 ton - GOE-ankues:

OE ankues kundërshton konstatimin e AK-së se gjysmërimorkioja e ofruar nuk përmbush kërkesën për peshë bartëse minimale 36 ton. Sipas AK-së, dokumentacioni tregonte 32,000 kg peshë bartëse, ndërsa OE ankues pretendon se libreza zyrtare e automjetit përcakton peshën maksimale prej 40,000 kg (40 ton). Ankuesi konsideron se AK e ka interpretuar gabimisht dokumentin zyrtar dhe se pajisja e propozuar e përmbush kërkesën e FDT-së. Sipas tij, vlerësimi duhet të bazohet në të dhënat objektive të librezës së automjetit dhe jo në interpretim tjetër të tyre.

Përgjigjje në pretendimin -7(e shtatë)

Kërkesa e autoritetit kontraktues është:

Rimorkio per bartjen e makinerive pesha bartse min 36t

SQARIMI:

Në dëshminë e ofruar nga GOE-ankues, e kanë ofruar në librezën e automjetit gjysmërimorkio, në librezë të dhënat janë:

n Te Robrika G- Masa pesha bartëse është 32,000 kg = 32 ton

n Pesha Maksimale e lejuar është 40 ton

n Pesha e gjysmërimorkios pa ngarkesë është është 8 ton.

Në bazë të të dhënave në librezë dhe kërkesës së autoritetit kontraktues gjysmërimorkios i mungojnë 4 ton për të arritur peshën bartëse prej 36 ton.

PRETENDIMI I SHTATË I GOE-ANKUES ËSHTË I PABAZUAR

PRETENDIMET E GRUPIT TE OPERATOREVE EKONOMIK SE GRUPI I OPERATOREVE EKONOMIK TE REKOMANDUAR NUK I PLOTESOJNE KERKESAT E AUTORITETIT KONTRAKTUES:

Lidhur me pjesën e pretendimit:

Grupi I Operatorve Ekonomik te rekomanduar për dhënie të kontrrates “Dorearti” Sh.p.k & “Lani-AL” Sh.p.k

Grupi I Operatorve Ekonomik te rekomanduar për dhënie të kontrrates “Dorearti”Sh.p.k & “Lani-AL” Sh.p.k nuk kanë arritur te deshmojë se e kanë permbushur kriterin tek Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2, ku kërkesa nga AK ka qenë:

“Për (LOT – 8) Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor I Operatorit Ekonomik, gjat tre vite të fundit financiar duhet te jet jo më pak se 900.000.00 Euro, qarkullimit vjetor për 3 vitet e fundit”.

Deshmia, për LOT 8 – Deklaratat e dorëzuara në Administraten Tatimore të Kosovës apo ne vendin e themelimit apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menagjimit të çertifikuara nga një firmë e njohur e licenensuar për kontrrollim apo një auditor I licensuar I pavarur.Grupi I operatorve ekonomik nuk I ka paraqitur këto deshmi te cilat e deshmojnë qe e plotëson këtë kriter dhe Nëse një kompani nuk e plotëson kriterin e qarkullimit vjetor të kërkuar në dosjen e tenderit, atëherë, në parim, nuk duhet të kualifikohet dhe nuk duhet të shpallet fituese. Autoriteti kontraktues është i detyruar ti zbatojë kriteret e kualifikimit ashtu siç janë përcaktuar në njoftimin dhe dosjen e tenderit. Gjithashtu, ligji parashikon se autoriteti kontraktues duhet të diskualifikojë operatorin ekonomik që nuk paraqet dëshmi të mjaftueshme se i plotëson kërkesat minimale financiare të përcaktuara në dosjen e tenderit.

SQARIMI:

GOE të rekomanduar për kontratë në folderin me emërtimin (1.CD - Dorearti & LANI) gjindet brenda folderit me subjektin e dokumentit “ Formulari i deklarimeve vjetore dhe pagesës për tatimet” në bazë të dëshmive të njëjta vlerat e ofruara përmbushin kërkesën e autoritetit kokntraktues.

Grupi I Operatorve Ekonomik te rekomanduar për dhënie të kontrrates “Dorearti” Sh.p.k & “Lani-AL” Sh.p.k nuk kanë arritur te deshmojë se e kanë permbushur kriterin tek Kërkesat mbi

mundësitë teknike dhe-ose profesionale 9.1 & 9.2, konkretisht tek Kontratat e ngjajshme ku kërkesa nga AK ka qenë: Për (LOT-8) Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të natyrës së ngjajeshme në vler prej 700.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3 vitet e shkuara. Për (LOT-8) Dëshmia: Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat për kryerje të punëve.

Grupi I Operatorve ekonomik "Dorearti" Sh.p.k & "Lani-AL" Sh.p.k I rekomanduar per dhenie te kontrrates nuk i plotëson as kriteret për përvojë të ngjashme (referenca dhe kontrata të ngjashme). Dokumentet e paraqitura nuk dëshmojnë realizimin e kontratave që përmbushin kërkesat minimale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit për natyrën, vlerën ose periudhën e kërkuar. Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar në mënyrë të barabartë kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e prokurimit, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik që kërkojnë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe vlerësim vetëm mbi bazën e kritereve të shpallura. Mos rrespektimi i kritereve të kualifikimit cenon parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së ndershme, duke e bërë vendimin për dhënie të kontratës të pabazuar në ligj dhe në dokumentet e tenderit.

<u>Kërkesa e autoritetit kontraktues është si në vijim:</u>

Për (LOT-8) Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të natyrës së ngjajeshme në vler prej 700.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.

SQARIMI:

Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3 vitet e shkuara.

Kërkesa e autoritetit kontraktues lidhur me kontratat dhe referencat, ka përshkrimin të ngjajshme, andaj lidhur me kontraten e dytë të cilën GOE-ankues konsidedrojnë se nuk është në pajtim me kërkesën e autoritetit kontraktues, për të njëjtën është në autoritetin e autoritetit kontraktues ta konsideroj si të ngjajshme apo jo pasi që kjo ndëlidhet edhe me objektin e kontratës. Andaj baza e vlerësimit në mes të terminologjisë " të ngjajshme " poashtu edhe " të njëjta " duhet të merret parasysh edhe opinioni i KRPP-së.

11. 09.06.2023 Cili është përkufizimi i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme" në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit?

GOE-ankues, pretendojnë se GOE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktues lidhur me stafin duke i specifikuar si në vazdhim:

Grupi I Operatorve ekonomik I rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e plotëson kriterin e stafit profesional, ashtu siç është kërkuar në Formularin e të Dhënave të Tenderit (FDT). Dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon se grupi i operatorëve ekonomikë disponon stafin minimal të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Përkundër këtij fakti, Autoriteti Kontraktues e ka

kualifikuar dhe shpallur fitues grupin e operatorëve ekonomikë “Dorearti” Sh.p.k & “Lani-AL” Sh.p., duke mos zbatuar kriteret e kualifikimit të përcaktuara në FDT dhe duke vepruar në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe ligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik. Për këto arsye, kërkojmë që vendimi për dhënie të kontratës të anulohet, grupi i operatorëve ekonomikë të diskualifikohet për mosplotësim të kriterit të stafit profesional dhe të bëhet rivlerësimi i ofertave në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

Inxhz. Nysret Kastrati I mungojnë referencat, dëshmija e punës si që është kërkuar në FDT, nuk ka paraqitur as kontrrata të me hershme qe deshmojnë një gjë të tillë e as trust penzional si që është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Inxhz. Leotrim Besim Kolloni njejtë I mungojnë referencat, dëshmija e punës si që është kërkuar në FDT, nuk ka paraqitur as kontrrata të me hershme qe deshmojnë një gjë të tillë e as trust penzional si që është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Inxhz. Fatlind Muhamet Sadikaj prap njejtë I mungojnë referencat, dëshmija e punës si që është kërkuar në FDT, nuk ka paraqitur as kontrrata të me hershme qe deshmojnë një gjë të tillë e as trust penzional si që është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Inxhznj. Ariana Lajqi Inxhiniere e Infrastrukturës Rrugore I mungonë Çertifikata e NVM-së e kërkuar në FDT.

Baxhellore e Ambientit znj. Fatbardha Ferat Ferataj, nuk e ka kualifikimin Inxhinier siç është kërkuar në dosjen e Tenderit, mirëpo Bachellor, gjithashtu çertifikaten e NVM-së e ka të skaduar me dt: 27.10.2025. Kërkesa në FDT - 6. Inxhinieri Ambientit, i certifikuar si NVM, me minimum 5 vite përvojë pune – pas diplomimit.

Kërkesa:

Për (LOT-8) Kërkesa 2 Stafi Profesional 1.Inxhinier i ndërtimtarisë, Bachelor, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit . 2.Inxhinier i Arkitekt, Bachelor, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit 3.Bachelor i Gjeodezisë, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit 4.Master i Shkencave në Xehetari, i specializuar për shpim-plasje – pas diplomimit 5.Master i Infrastrukturës Rrugore, i certifikuar si NVM, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit 6.Inxhinier i Ambientit, i certifikuar si NVM, me minimum 5 vite përvojë pune – pas diplomimit 7.Master i Hidroteknikës, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Për (LOT-8) Deshmia 2 Për secilin anëtar të stafit duhet të dorëzohen këto dëshmi Diploma universitare përkatëse (Bachelor ose Master); CV profesionale e nënshkruar; Certifikata licenca profesionale përkatëse, aty ku kërkohet; Certifikata NVM, për pozitat ku kërkohet; Dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrat ne emer te projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti). sipas viteve të kërkuara.

Pjesa e pretendimit të përgjtihshëm të GOE-ankues:

Inxhz. Nysret Kastrati I mungojnë referencat, dëshmija e punës si që është kërkuar në FDT, nuk ka paraqitur as kontrrata të me hershme qe deshmojnë një gjë të tillë e as trust penzional si që

është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Kërkesa e autoritetit kontrsaktues:

1. Inxhinier i ndërtimtarisë, Bachelor, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrat ne emer te projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti). sipas viteve të kërkuara.

SQARIMI:

rupi i operatorëve ekonomik në listën e paraqitur për stafin nga operatori Dorearti Sh.p.k si inxhinier të ndërtimtsarisë e ka paraqitur Nystret Kastrati, në dëshmitë e ofruara për të njëjtin lidhur për përvojën e punës nuk janë ofruar dëshmi sipas kërkesës së autoritetit kontraktues për përvojën e punës për 3 (tri) vite ashtu siq është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Lidhur me stafin për Inxhinierin e ndërtimtarisë, GOE të rekomanduar për kontratë nuk e plotësojnë këtë kërkesë.

GOE - ankues pretendojnë se GOE- të rekomanduar për kontratë nuk e plotësojnë kërkesën pë inxhinierin Leotrim Besim Kolloni: Bachellor i Gjeodozisë:

Inxhz. Leotrim Besim Kolloni njejtë i mungojnë referencat, dëshmija e punës si që është kërkuar në FDT, nuk ka paraqitur as kontrrata të me hershme qe deshmojnë një gjë të tillë e as trust penzional si që është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Kërkesa e autoritetit kontraktues:

2. Bachelor i Gjeodezisë, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit

Dëshmia:

Dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrat ne emer te projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti). sipas viteve të kërkuara.

SQARIMI:

Grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontrstë, në listën e paraqitur për stafin nga operatori Dorearti Sh.p.k si bachellor të Xheodezisë e ka paraqitur Leotrim Kololli, në dëshmitë e ofruara për të njëjtin lidhur për përvojën e punës nuk janë ofruar dëshmi për përvojë të punës dhe kërkesa nuk është përmbushur.

Lidhur me stafin për Inxhinierin e ndërtimtarisë, GOE të rekomanduar për kontratë nuk e plotësojnë këtë kërkesë.

GOE - ankues pretendojnë se GOE- të rekomanduar për kontratë nuk e plotësojnë kërkesën për 7.Master i Hidroteknikës, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit përfaqësuar nga Fatlind Muhamet Sadikaj:

Inxhz. Fatlind Muhamet Sadikaj prap njejtë I mungojnë referencat, dëshmija e punës si që është kërkuar në FDT, nuk ka paraqitur as kontrrata të me hershme qe deshmojnë një gjë të tillë e as

trust penzional si që është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Kërkesa:

7. Master i Hidroteknikës, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmi për përvojën e punës (kontrata pune ose parakontrat ne emer te projektit, referenca, vërtetime nga punëdhënësi ose dëshmi nga Trusti). sipas viteve të kërkuara.

SQARIMI:

Grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontrstë, në listën e paraqitur për stafin nga operatori Dorearti Sh.p.k për Master i Hidroteknik e ka paraqitur Muhamet Sadikaj, në dëshmitë e ofruara për të njëjtin lidhur për përvojën e punës nuk janë ofruar dëshmi për përvojë të punës dhe kërkesa nuk është përmbushur.

GOE - ankues pretendojnë se GOE- të rekomanduar për kontratë nuk e plotësojnë kërkesën për Inxhznj. Ariana Lajqi Inxhiniere e Infrastrukturës Rrugore i mungonë Çertifikata e NVM-së e kërkuar në FDT.

Kërkesa e autoritetit kontraktues:

5. Master i Infrastrukturës Rrugore, i certifikuar si NVM, me minimum 3 vite përvojë pune – pas diplomimit

Dëshmia:

Certifikata NVM, për pozitat ku kërkohet;

SQARIMI::

Në dëshmitë e ofruara nga GOE të rekomanduar për kontratë, lidhur me çertifikatën e kërkuar MVN, nuk është dorëzuar në ofertë, janë dorëzuar vetëm Lincenca A, Certifikatë trajnimi AutoCad civil 3 D +nPlateia.

Kërkesa e autoritetit kontraktues nuk është përmbushur dhe pjesa e pretendimit të GOE-ankues është i bazuar.

GOE - ankues pretendojnë se GOE- të rekomanduar për kontratë nuk e plotësojnë kërkesën për Baxhellore e Ambientit znj. Fatbardha Ferat Ferataj, nuk e ka kualifikimin Inxhinier siç është kërkuar në dosjen e Tenderit. Baxhellore e Ambientit znj. Fatbardha Ferat Ferataj, nuk e ka kualifikimin Inxhinier siç është kërkuar në dosjen e Tenderit, mirëpo Bachellor, gjithashtu çertifikaten e NVM-së e ka të skaduar me dt: 27.10.2025. Lidhur me pretnedimin se nuk ka kualifikim inxhinier mirëpo bachellor, sqaroj se kërkesa e autoritetit kontraktues është si në vazhdim:Për (LOT-8) Deshmia 2 Për secilin anëtar të stafit duhet të dorëzohen këto dëshmi Diploma universitare përkatëse (Bachelor ose Master). Në bazë të kërkesës për kualifikim GOE të rekomanduar për kontratë e plotësojnë kërkesën ndërsa lidhur me çertfikaten NVM, konifrmoj se afati i çertifikatës është prej :27.102020 deri më: 27.10.2025, andaj konfirmoj se çertifikata nuk ka validitet.

Kërkesa e autoritetit kontraktues nuk është përmbushur dhe pjesa e pretendimit të GOE-ankues është i bazuar.

PËRFUNDIM

l Në bazë të arsyeve të dhëna për pretendimet e GOE-ankues, sqaroj se pretendimet nga 1 deri në 7 të parashtruara (me numër) nga GOE-ankues nuk janë të bazuara.

l Lidhur me pjesën e përgjithshëme të pretendimeve të GOE-ankues, në raport me GOE të rekomanduar për kontratë, sqaroj se ka mangësi të plotësimit të kërkesave për stafin nga GOE të rekomanduar për kontratë, andaj gjatë rivlerësimit, autoriteti kontraktues ti trajtoj në bazë të nenit 72 dhe nenin 59 të LPP-së.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP-se lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si pjeserishte e bazuar, mirpo Paneli Shqyrtues nuk e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhenie të kontrates dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim për arsye se edhe ne raportin e ekspertizës vet eksperti shqyrtues sipas pretendimeve nga 1 deri ne 7 i ka cilësuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit , poashtu, eksperti shqyrtues ne raportin e tije ka konstatuar mangësi në përmbushjen e kërkesave për stafin profesional edhe në ofertën e grupit të operatorëve ekonomikë të rekomanduar për kontratë nga ana e AK-se , dhe në këtë procedur PSH nuk mund ta mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues i cili konsiderohet qe është jo profesional

Rrjedhimisht, në këtë aktivitet nuk ekziston asnjë ofertë e përgjegjshme që mund të rekomandohet për dhënie të kontratës. Për këtë arsye, kthimi i LOT 8 në rivlerësim nuk mund të prodhojë një rezultat tjetër ligjor, pasi mangësitë e konstatuara lidhen me mosplotësimin e kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktues në Njoftimin për Kontrate dhe Dosjes së Tenderit, dhe dokumentet e munguara nuk mund të plotësohen pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave pa përbërë ndryshim material të ofertës sikurse parashihet ne nenin 72

paragrafi 3 i LPP-se .

Andaj nga gjithe elaborimi i kësaj procedure, dhe në mbështetje të nenit 1 dhe 7 të LPP-se, Paneli Shqyrtues ka vendosur ta anulon në tërsi LOT 8 *‘’Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sejnovë – Gjorë, Kodi 54660’’* , me nr. të prokurimit: "635-26-3347-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES, në munges të ofertave të përgjegjshme për Lot 8, kjo duke u mbështetur në nenin 1 par36, 52,56 dhe 60 të Ligjit të Prokurimit Publik.

-Përfundim-

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahimi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PEJES**
- OE - **N.T. „Fer-Petroll**
- Arkivës së OSHP-së: